



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201601301/12

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumentave të pronësisë në favor të shtetases V.E.M(L) për pasurinë, me nr.2/330, ZK 8591, trull me sipërfaqe 186 m2 dhe shtëpi banimi me sipërfaqe 54 m2 e ndodhur në L.K.Përmetit, Rruga O.Kuka.*

**Drejtuar :** **Shpëtim Lame**  
Rregjistrues i Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,

**SHKODËR**

**Për dijeni :** **Ministrisë së Drejtësisë**

**Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të pasurive të Paluajtshme**  
Z.Ilirjan Muho

**V.E.M(L)**

Adresa:

**SHKODËR**

Z.Rregjistrues!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetases V.E.M. (L), në të cilën prezantohet shqetësimi për moslëshimin e dokumentacionit të pronësisë për pasurinë e regjistruar në emër të trshëgimlënësit E.N.L me numër rradhori 1769, datë 05.09.1994, sot me numër pasurie 2/330, ZK 8591, mbi bazë të titullit të pronësisë, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1373, datë 25.04.1993, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, me objekt:

*“Vërtetimin e faktit juridik të njohjes së pronësisë mbi një shtëpi banimi të kërkuessit E.L të ndodhur në Lagjen K.Përmetit, Rruga “O.Kuka” që përbëhet nga 2 kate, në katin përdhe një sobë, 1 koridor, 1 ahur, WC dhe kati i dytë ka dy dhoma dhe një koridor që kufizohet para S.Z, mbrapa me Z.L, majtas me B.L, djathtas me oborrin e Z.L, si dhe një sipërfaqe oborri prej 2 pjesë shtëpija e kërkuesses Z.L është 2 katëshe e ndodhur në Lagjen*

*k/Përmetit, ka në katin përdhe një sobë, një aneks, një koridor, shkallët dhe ahur, ndërsa në katin e dytë ka dy dhoma, një kuzhinë, 1 koridor e WC, që kufizohet para me E. L, prapa me F.B, djathtas me shtëpinë e H.B, majtas me H.L si dhe një sipërfaqe oborri dhe 1 pus”.*

Për këtë çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar informacion dhe shpjegime ZVRPP, Tiranë, rreth shkaqeve të cilat justifikojnë moslëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të ankueses, konform kërkesës (aplikimit) të përsëritur të kryer prej saj.

Në përgjigje të kërkesës për dhënie informacioni dhe shpjegimesh, ju z.Regjistrues, me Tuajën nr. 109/1 Prot, datë 10.01.2017, drejtuar Avokatit të Popullit, shpreheni se, shkak për moslëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të ankueses është mosvënia në dispozicion prej ankueses e kopjes origjinale apo të njehsuar me origjinalin të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1373, datë 25.04.1993, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër. Në kushtet kur pasuria e paluajtshme, për të cilën ankuesja kërkon lëshimin e dokumentacionit të pronësisë figuron e regjistruar në rradhorin nr. 1769, datë 05.09.1994, në emër të trshëgimlënësit E.N.L, nuk mund të mirëkuptohet kërkesa drejtuar ankueses për vënien nga ana e saj në dispozicionin tuaj, të vendimit gjyqësor civil të lartpërmendur mbi bazë të të cilit është kryer regjistrimin i pronës. Përderisa është mundësuar prej ZVRPP, Shkodër, regjistrimi i Titullit të Pronësisë, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1373, datë 25.04.1993, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, prezumohet se, kopja e dorëzuar në momentin e regjistrimit në rradhorin 1769, datë 05.09.1994, në emër të trshëgimlënësit E.N.L, ka qenë origjinale. Kërkesa juaj për rivënien në dispozicion prej ankueses të një kopjeje të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1373, datë 25.04.1993, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, është e pabazuar. Në rast se kopja e vendimit gjyqësor në fjalë është e administruar si fotokopje, siç dhe ju shpreheni, në momentin e regjistrimit të tij, datë 05.09.1994, atëhere do të duhet që në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 196 të Kodit Civil, i cili parashikon se ;

*“Gjykatat, noterët, përmbauesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t'i dërgojnë për regjistrim zyrës që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë”,*

të kërkonti pranë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, mundësimin e konfirmimit të dhënies së Vendimit nr. 1373, datë 25.04.1993, prej saj. Përderisa ZVRPP, Shkodër, ka kryer regjistrimin e Titullit të Pronësisë, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1373, datë 25.04.1993, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, dhe lëshuar vërtetim Pronësie datë 30.09.1994, në favor të subjektit pronar, nuk mund të pengohet ky subjekt që të pajiset me dokumentacion pronësie referuar pretendimeve të ZVRPP, Shkodër.

Qëndrimi i shprehur nga ana juaj për moslëshimin e dokumenteve të pronësisë për pasurinë me numër rradhori 1769, datë 05.09.1994, sot me numër pasurie 2/330, ZK 8591, nuk ka bazë ligjore e cila do të mund të përligjte këtë qëndrim, e për rrjedhojë ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për regjistrimin e titutjve të pronësisë, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Funksionimi i organit që ju përfaqësoni në procesin e dhënies së shërbimit të kërkuar prej ankuesit, konstatohet se, nuk vjen në respektim të parimit të ligjshmërisë, përgjegjësisë, të parashikuara në nenin 4 dhe 15 të Kodit të Procedurës Administrative dhe detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Qëndrimin e derisotëm të mbajtur nga ana juaj e vlerësojmë në cënim të së drejtës së pronësisë, parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar respektivisht në nenin 41, 42 të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit ankues.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ushtrimin e detyrave prej Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palaujtshme, Tiranë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsytet e lartpërmendura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin sanksionohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumentave të pronësisë në favor të shtetases V.E.M (L) për pasurinë, me nr.2/330, ZK 8591, truall me sipërfaqe 186 m2 dhe shtëpi banimi me sipërfaqe 54 m2 e ndodhur në L.K.Përmetit, Rruga O.Kuka.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Me besim në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ (SALIU)**

**Konceptoi dhe Daktilografoi  
A.Gjoleka**